ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Ministria e Punëve të Brendshme

Për Aktivitetin e Prokurimit:
Numri i Prokurimit: **214-23-6442-5-1-1**
Titulli: **"LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të"**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK
GO.E " EBK -SHPK, PRO ARK CONSTRUCTION SHPK,NPN UNIVERS M-I.

BUJAR GODENI P.N.H2K1 NR 3

PRIZREN *20.000)*

049-509 237

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

FLAMUR SHEFKIU

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
EBKOSOVA@gmail.com
(Adresa elektronike)

18.06.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

NJOFTIMI PER KONTRATE DATE 25.06.2023
KORIGJIM I GABIMEVE SQARIME DATE 06.07.2023
HAPJA E TENDEREVE DATE 07.08.2023
VENDIMI I AK PER DHENJE TE KONTRATES DATE 20.03.2024
KERKESA PER RISHQYRTIM 3 NE VITIN 2023
NJOFTIM PER DHENJE TE KONTRATES LOT 1 DATE 05.02.2023
VENDIMET E OSHP ASTRAPLAN 06.11.2023
VENDIMET E OSHP EBR 06.11.2023
KERKESA PER RISHQYRTIM DATE 28.03.2024
KERKESA PER RISHQYRTIM DATE 28.03.2024
VENDIM AK PER DHENJE TE KONTRATES DATE 27.05.2024

KERKESA PER RISHQYRTIM DATES date 03.06.2024
VENDIMI KUNDER KERKESES PER RISHQYRTIM date 05.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

HAPJE E-PROKURIM

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. KERKESA PER RISHQYRTIM DATE DATE 03.06.2024 VENDIMI I AK KUNDER KERKESES PER RISHQYRTIM 05.06.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

O.E KONSIDERON SE JANE SHKELUR KETO NENE **Ligji PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Nr. 04/L-042** **I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092** **NENI 1-QËLLIMI** **NENI 6 -EKONOMICITETI DHE EFIKASITETI** **NENI 7 – BARAZIA NË TRAJTIM -JO DISKRIMINIMI** **NENI 53-SIGURIMI I INFORMATAVE SHTESË** **NENI 59-EKZAMINIMI VLERËSIMI I TENDEREVE** **NENI 60 -KRITERËT PËR DHENJE TE KONTRATËS** **Udhëzuesi dhe Rregullorja e PP 01/2022 pika 28 .2**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shkeljet e pretenduara

Petendimi nr 1

Ne si O.E. ankues konstatojmë se është bërë shkelje e nenit 1, QËLLIMI, i ligjit të prokurimit me vetë faktin se A.K. me Vendimin për Anulim të ofertës sonë me vlerë prej 106.976.85 euro më e ulet se oferta e fituesit, krijohet mundësia për keqpërdorim të buxhetit për vlerën e cekur më sipër sepse ka shpallur fitues një OE me ofertë shumë më të lartë sesa oferta jonë.

Pretendimi nr. 2

OE ankues në këtë procedurë prokurimi, jemi të bindur se është shkelur neni 1,2 dhe 3 të LPP-së, sepse ka diskriminuar grupin tonë të OE dhe haptas ka favorizuar operatorin tjetër të cilën e ka shpallur fitues në këtë procedurë prokurimi. Me datën 28.03.2024 kërkesa jonë për ri-shqyrtim eshtë pranuar dhe në bazë të ankesës tonë, lënda është kthyer në ri-shqyrtim duke konstatuar se oferta jonë ka qenë e pergjegjshme, kurse tani pas vendimit të OSHP-së, AK, e shpallë ofertën tonë të papërgjegjshme dhe me ketë rast krijohen dualizma dhe vlerësim i dyanshëm.

Pretendimi nr. 3

A.K. në vendimin për refuzim, konstaton se oferta e OE-ankues, është e papërgjegjshme, por harron se në kërkesën per rishqyrtim te dates 28.03.2024 ka vlerësuar si të bazuar ankesën tone duke pranuar se oferta jonë ishte e pergjegjeshme dhe nuk i mungonte as Inxhinieri dhe as Sigurimi i tenderit. Por në ekzaminimin dhe vlerësimin pasi lënda është kthyer në ri-shqyrtim, oferta jonë shpallet e papërgjegjshme me arsyetimin se nuk e kemi vazhduar sigurimin e tenderit. Në vendimin e datës 05.06.2024 per refuzim të ankesës tonë, AK i ka bashkangjitur kërkesën, formularin standard B47 per vazhdim të sigurimit të tenderit dhe validitet të ofertës por e njejta është e datës 02.02.2024. në baze te vendimit për dhënje te kontrates i dates 27.05.2024 oferta jone shpallet e papergjegjeshme me konstatimin se nuk e ka vazhduar sigurimin e ofertës.
Për më tepër, AK prej datës 28.03.2024, kohë kur lënda është kthyer në ri-vlerësim dhe deri me datën 27.05.2024, A.K nuk ka kërkuar nga grupi ynë i OE, vazhdimin e sigurimit dhe si duket kjo është bërë me qëllim për ta eliminuar ofertën tonë. Për ta argumentuar këtë pretendim, keni provën më poshtë si dëshmi se A.K nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit dhe sigurimin e tenderit.

Ligji e përcakton qe nëse kërkohet një vazhdim i validitetit të tenderit, përkatesisht vazhdimi i sigurimit të tenderit, duhet dërguar të gjithë pjesmarrësve në tender.



Pra, ashtu siq edhe shihet në platformën e-prokurimi, por as përmes e-maili, A.K. nuk ka kërkuar vazhdim të sigurimit të tenderit nga grupi i O.E EBK, së bashku me anëtarët e tjerë të konzorciumit. Për këtë arsye, vlerësojm se A.K ka diskriminuar neve si OE duke favorizuar OE të shpallur fitues.

Në si grup i O.E kemi bashkangjitur sigurimin e tenderit për dy lotet dhe sigurimi mbulon periudhën nga data 03.04.2024 deri 02.06. pas 2024, kohë kjo e cila është dashur A.K të kërkoj nga grupet e OE, sigurimi i tenderit sepse lënda është kthyer në ri-vlerësim disa herë.

Provë. Sigurimi i tenderit i bashkëngjitur si provë dhe e cila lehtësisht mund të vlerësohet nga eksperti shqyrtues në fazën e vlerësimit si dhe nga paneli shqyrtues gjatë gjykimit të procedurës së prokurimit.

ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr.19,
Tel: +383 (0) 38 221 112- Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË TENDERIT

Nr. Polices: ***126157***

Kontraktuesi	
Emri	EBK SH.P.K.
Përfaqësuar nga	Flamur Shefiku
Adresa	Prizren, BUJAR GODENI PN.
Nr i Biznesit	811290874
Telefoni	044509237
Përfituesi	
Emri	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Adresa	Prishtinë
Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB
Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	32,000.00
Periudha Sigurimit	03.04.2024 - 02.06.2024
Primi	240.00
Tvsh	43.20
Primi Bruto	283.20
Data e lëshimit	28.05.2024 09:25

Aktiviteti Ekonomik:
LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të.

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësoje çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesi/Garantuesi).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave – pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions

Kompania e Sigurimeve Elsig
Bajram Fazliu- 1940

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG INSURANCE COMPANY

Përfaqësuesi i të siguruarit
Flamur Shefiku

Udhezuesi i PP 2022- Pika 28 -Sigurimi i tenderit
28.2 Sigurimi i tenderit është opsional që nënkupton që në rast të kontratave me vlerë të madhe dhe të mesme, AK mund të imponoj kërkesën e sigurimit të tenderit.

Për ketë arsye konstatojm se është shkelur Neni 7.par.7.8.9.10.11 dhe 12 të LPP-së
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Pretendimi nr. 5

Jemi të bindur se AK ka shkelur nenin 59, par,1,2,3,4,5, Ekzaminimi, Vlërësimi dhe Krahasimi i tenderëve, pastaj nenin 60.par.1, nënpar.1.1 dhe 1.2 si dhe par.2, Kriteret për Dhënien e Kontratës, të LPP-së dhe atë si vijon.

A.K, ka shpallur fitues ofertën e OE, ASTRAPLAN, por nga ekzaminimi dhe vlerësimi i dokumentacionit ofertës fituese, evidentohen se mungojn dokumentet në fajlet me numër 5.3 dhe 5.8 ne të cilat do të eshtë pershkruar dokumentacioni i stafit të kualifikuar sipas kërkesës së A.K andaj, konstatojm së oferta e OE të shpallur fitues është e papërgjegjshme, Ne kemi dyshime se tek stafi i kualifikuar mungon cv dhe kontrata punës e inxhinierit sipas kërkesës së AK, por edhe të stafit tjetër për shkak se ne si operator ekonomik nuk kemi pas qasje të hollësishme në fajlat nr 5.3 dhe 5.8 dhe për ketë arsye kërkojm që eksperti shqyrtues të ekzaminoj dokumentacionin e fajlave të sipërpërmendur në mënyrë që të sqarohet dhe evidentohet lista e stafit të kërkuar dhe të konstatoj se a janë plotësuar kriteret e tyre konform kërkesës së dosjes së tenderit.

PËRFUNDIM

KËRKOJMË nga OSHP, të **APROVOJ** të bazuar ankesën e GO.E " EBK -SHPK, PRO ARK CONSTRUCTION SHPK,NPN UNIVERS M-I.

ANULOJ-Njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM,**

Detyrohet AK që gjatë ri-vlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhët në harmoni me kerkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të ligjit të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania është dëmtuar si në aspektin moral por edhe në aspektin material duke refuzuar ofertën tonë, dhe kur kësaj ti shtohet fakti se pothuajse që 1 vit lënda është duke u zvarritur herë në një autoritet e herë në një tjetër e që eshtë një kosto shumë e lart duke u angazhuar në përgaditjen e kërkesave për ri-shqyrtim (3 herë) dhe Ankesa në OSHP në vitin 2023 e si kosto materiale llogaritet mbi 10.000.00 euro

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*